



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.469/7 prot.

Datë 25.02.2026

**V E N D I M**  
**Nr. 316/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

|                  |            |
|------------------|------------|
| Fiorent Zguro    | Nënkryetar |
| Kreshnik Ternova | Anëtar     |
| Gjergj Mersini   | Anëtar     |

Në mbledhjen e datës 25.02.2026 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Korrigjim Formular për Publikim

**Subjekte të interesuar:** Operatori i Blerjeve të Përqendruara me adresë Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).

Operatori ekonomik “Fedos” SHPK me NIPT K01514009I dhe adresë: Rruga Kujtim Laro -Tirane,Nr pasurie 3/22,Kati 2, Tiranë.

Operatori ekonomik “Albadent Group” SHPK me NIPT L62217032L dhe adresë: Rruga Allaman Dervishi, Pallati Classic A.M. Nr.31, Kthesa e Kamzës, Tiranë.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave

*Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik,

**Vëren:**

Në datë 13.02.2026 Komisioni i Prokurimit Publik publikoi Formularin për Publikim Nr.469/1 prot., për ankesën me numër ankimi elektronik A/2026/6325 si dhe nr. Protokolli 469/2026 datë 13.02.2026 e operatorit ekonomik “Fedos” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-72023-12-12-2025, me objekt: “LOTI 2 Filtra deleukocitar dhe bashkues laborator për masat trombocitare”, me fond limit 18,960,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 15.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

**Komisioni i Prokurimit Publik**

**Arsyeton:**

I.1. Me nismën e vetë organit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon që të korrigjojë Formularin për Publikim për ankesën me numër ankimi elektronik A/2026/6325 si dhe nr. Protokolli 469/2026 datë 13.02.2026 e operatorit ekonomik “Fedos” SHPK,

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

**Vendos**

1. Të korrigjojë Formularin për Publikim për ankesën me numër ankimi elektronik A/2026/6325 si dhe nr. Protokolli 469/2026 datë 13.02.2026 e operatorit ekonomik “Fedos” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-72023-12-12-2025, me objekt: “LOTI 2 Filtra deleukocitar dhe bashkues laborator për masat trombocitare”, me fond limit

18,960,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 15.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara, si më poshtë:

### **Ishte**

Lidhur me operatorin ekonomik “Albadent Group” SHPK ankimuesi pretendon se nuk përmbush kërkesat/kriteret si më poshtë

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit të lotit 2/shumatores së loteve që konkuron. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë skedë teknike/katalog teknik nga prodhuesi për të gjitha mallat objekt prokurimi të lotit 2, ku të pasqyrohen specifikimet teknike të kërkuara. Në katalog duhet të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të artikullit të ofruar, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet standarde të tenderit, të përcaktuara në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike”.

### **Bëhet**

Lidhur me operatorin ekonomik “Albadent Group” SHPK ankimuesi pretendon se nuk përmbush kërkesat/kriteret si më poshtë:

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më

pak se 40 % e vlerës së fondit limit të lotit 2/shumatores së loteve që konkuron. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë skedë teknike/katalog teknik nga prodhuesi për të gjitha mallat objekt prokurimi të lotit 2, ku të pasqyrohen specifikimet teknike të kërkuara. Në katalog duhet të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të artikullit të ofruar, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet standarde të tenderit, të përcaktuara në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike”.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra për të gjitha mallrat objekt prokurimi të Lotit 2, sipas paketimit të kërkuar në specifikimet teknike. Mostra duhet të ketë etiketën sipas prodhuesit.

-Mostrat do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a në datën dhe orën e hapjes së tenderit, me adresë: Rr “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).

Gjithashtu, ankimuesi në ankesë lidhur me kriterin (6) pretendon: *Kërkojmë një ekspertizë të posaçme për testim dhe vlerësim paraprak të mostrave të dërguara nga operatori ekonomik në momentin e hapjes së tenderit, që vërteton përputhshmërinë me çdo kriter të kërkuar në specifikimet teknike*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

